

Fjalor i Terminologjisë tekniko-shkencore, 1. Terminologjia e Botanikës (shqip-rusisht-frëngjisht), Bot. i Sektorit të Terminologjisë të Institutit të Historisë dhe të Gjuhësisë (Universiteti Shtetëror i Tiranës), Tiranë, 1963, 92 fq.

Ky fjalor special tri gjuhësh (shqip-rusisht-frëngjisht) asht i pari i serisë "Fjalor i Terminologjisë tekniko-shkencore" që ka fillur të botohet nga Sektori i Terminologjisë i Institutit të Historisë dhe Gjuhësisë.

Puna sistematike për hartimin dhe njësimin e terminologjive shkencore shqip ka fillur që në vitin 1956 me krijimin e Sektorit të Terminologjisë pranë Institutit të Historisë dhe të Gjuhësisë.

Në parathanie tregohen përmbledhtas, në 5 pika parimet dhe kriteret që janë ndjekë për hartimin e fjalorëve terminologjikë mbi baza me të vërtetë shkencore dhe jo thjesht empirike. 1) Të shfrytëzohen sa ma shumë mundësitë e mëdha që ka gjuha jonë për fjalëterma dhe prirja që ka marrë zhvillimi i gjuhës letrare në kohën tonë. 2) Të shfrytëzohen sa ma shumë e sa ma mirë mënyrat dhe tipat ma prodhues të formimit të fjalëve në gjuhën shqipe. 3) Të shqipërohen temat shkencore jo ndërkombëtare tue quejtë ndërkombëtare ata terma që i kanë të përbashkët jo vetëm dy ose ma shumë gjuhë neolatine por që i kanë edhe gjuhët e tjera. 4) Të rivlerësohenin sa qe e mundun disa terma të vjetër të përdorun qysh në kohë të Rilindjes dhe të braktisun ma vonë. 5) Të kihet parasysh përhapja dhe përdorimi i nji termi në kohën tonë si në shkolla, ashtu dhe në degët e ndryshme të prodhimit.

Të gjitha këto kriteret janë respektue gjatë punës për hartimin e terminologjisë së botanikës.

Botanika asht një lëndë mjaft e randësishme që fillon të mësohet që në bangat e shkollës fillore e prandaj edhe termat e saj kanë nji randësi të veçantë jo vetëm nga pikpamja thjesht shkencore por edhe nga ana gjuhësore. Nxanësit do të mësohen me termat shqip, të cilat do t'u japin mundësi të njihen ma mirë e ma thellë me vetë fenomenet ose sendet që shënojnë ata terma.

Të 1202 termat e fjalorit terminologjik të botanikës përfshijnë termat ma kryesore të botanikës dhe me këtë punim të randësishëm leksikografik asht hedhura baza për hartimin ma vonë të nji fjalori ma të plotë të botanikës (ku të përfshihet edhe sistematika e bimëve).

Për të pasë sukses në hartimin e terminologjive shkencore, sidomos në kushtet tona të zhvillimit të shkencave dhe të gjuhës, — duhet nji bashkëpunim i ngushtë në mes të gjuhëtarëve dhe specialistëve. Për hartimin e fjalorit të botanikës asht plotësue ma së miri ky kusht; kanë marrë pjesë botanistë dhe gjuhëtarë të shquem të vendit tonë dhe ky bashkëpunim frytëdhanës shihet kudo në këtë fjalor të hartuem me kriteret të shëndosha shkencorë dhe gjuhësore.

Mjafton të vemë në dukje se nga të 1202 termat që përmban fjalori 871 janë fjalë shqipe dhe vetëm 331 janë fjalë me rranjë të hueja, tue përfshi këtu edhe të ashtuquejtunat internacionalizma ose fjalë me prejardhje ose rranjë greke e latine që takohen në shumë gjuhë, të tilla si *gjenetikë, graminoid, monokarpik, monogjin, parazit, partenogjenezë, peristomë* etj.

Për pasunimin e terminologjisë me fjalë shqipe janë shfrytëzue gjuhësisht dhe me kriter mjetet fjalëformuese të shqipes, sidomos prapashtesat. Kështu kanë dalë fjalë të goditura mirë shqip me prapashtesa zvogëlimi: *bërthamëz* (fr. *nucléole*), *kallith* (fr. *épillet*), *kapak* (fr. *opercule*), të cilat duket sikur i ka mbarë gjuha shqipe. Por duhet pasë kujdes në përdorimin e prapashtesës -zë e cila jo gjithmonë i jep fjalës nuancë zvogëlimi. Termi pështjellë. (fr. *involute*) ka rrezik të kuptohet si *involute* (që në fjalor asht dhanë me fjalën *pështjellë*). Përkërisht në fjalët që tregojnë ndonjë objekt special, ndonji vegël, mjet, prapashtesa-zë e ka humbë

në shumë raste kuptimin e zvogëlimit. Kështu kemi *mollëzë* (*mollëza* e faqes), *shtjekëzë*, *thje rëzë* etj.; të gjitha këto fjalë shënojnë objekte të caktueme pa farë nuance zvogëlimi.

Nji vend të mirë zanë në fjalor edhe kompozitat, të krijueme me kritere të shëndosha gjuhësore dhe tue u qëndrue besnike modeleve popullore. Kështu kemi: *nenpetëldarë* (fr. *dyalisépale*); *petëlngjashëm*; *petëlngjitur*; *petëlshumë*; *pyllëshumë* (prolifëre); *shumëçarë* (fr. *multifide*); *shumëkokës*, — e (fr. *polycépale*). Janë krije me vend edhe disa fjalë abstrakte të cilat i mungojnë shqipes por janë të nevojshme: të tilla janë termat *pylltari* (*sylviculture*); *nyjsi* (nodositë). Ky tip fjalësh me prapashtesat *-i*, *-si* asht prodhues në gjuhën shqipe; fjalët *këmishari*, *pulari*, *mezeri* dëgjohen shpesh edhe në gjuhën e folun.

Në shumë terma të botanikës vërtetohet edhe një herë parimi se në shumicën e rasteve fjala shqip asht ma prodhuese, i pranon ma me lehtësi elementet afiksale shqip, se fjala e huazume ose fjala e huej. Kjo provohet nga fjalët të tilla si *dellezim*, *dellëzoi*, *dellëzuar* (nga emni *dell*). Këtu mund të shtohet edhe *dellësi* (për fr. *nervure*) që në fjalor asht lanë *nervurë*, më duket pa një nevojë të domosdoshme.

Janë zavëndësue me sukses fjalët e hueja të cilat kanë hy kohët e fundit pa asnji nevojë. Kështu tók termat *gyp me shosha* dhe *gyp pjalmor* asht zavëndësue fjala *tub* që duhet luftue dhe shmangë nga gjuha jo vetëm në botanikë por edhe në çdo fushë tjetër si një barbarizëm i kotë.

Janë zavëndësue me terma shqip edhe disa terma të huej që do të vlejnë edhe për terminologji të tjera. I tillë asht termi *enëzor* për frengjishten *vasculaire* që duhet të përdoret edhe në zoologji, mjeksi etj. kudo që pa arsye të mjaftueshme përdoret fjala *vaskular*.

Kur hartohen terma të reja i duhet kushtue vemendje edhe anës fonetike të termit. Duhet evitue sidomos çdo homonimí që mund të sjellë ngatërresa në kuptimin e termave. Kështu ndodh tek termat: *degës*, — e (mbiemën) dhe *degëz-a* (emën); *kupës-e* (mbiemën) dhe *kupëz-a* (emën); në të dy rastet kemi të bajnë me homofone dhe kur shqiptohen vështrësohet shumë dallimi i emnave nga mbiemni.

Po rrjeshtojmë dhe disa vërejtje në lidhje me terma të veçanta të fjalorit:

bazilar, -e — Fjalë e huej e cila duhej zavëndësue me shqipen, mbasi përdoret në shumë fusha e jo vetëm në terminologjinë e botanikës (shqip kemi fjalët: themelor, kryesor).

bardhëremë (i,e) — Ky mbiemën na duket i tepërt, i përdorun krahas mbiemnit i *bardhemë*. Nuk takohet as në fjalorë që kanë: i *bardhemë*, *bardhok*.

ballsamor — Të përdorej ma mirë fjala *balçëm* në vend të *ballsam* mbasi forma e parë asht ma e vjetër në shqipen dhe fjalët e prejardhuna nga ajo marrin prapashtesa shqipe (balçmoj, i balçmueshëm etj.). Për ma tepër në shqip kemi edhe një bimë të quejtun balç-balçi (*hypericum perforatum* — bimë me lule të verdha dhe me erë si të ballsamit — Fj. Inst. Shkencave 1954, fq. 25).

bijim-i shih *brezni* — Vetëm termi *brezni* u përgjigjet termave frengjisht dhe rusisht: gëneration, поколение. Termi *bijim* i përgjigjet vetëm termit frengjisht gëneration që ka dhe kuptimin e procesit (bijim) dhe të rezultatit (gëneration), kurse në rusisht поколение ka vetëm kuptimin e rezultatit, d.m.th. *ë vezni* dhe jo *bijim*. Kjo e fundit në rusisht përkthehet *рождение, зарождение*.

bishtalec — Këtu asht dhanë për *bisht* i *vogël*. Fjala njihet me një kuptim të caktuem: gërshet (shih edhe fjalorin e Institutit të shkencave, 1954), prandaj nuk duhej përdorë me kuptimin *pëtiolule*. Mund të shfrytëzoheshin fjalët "bishtël" ose "bishtëth" (bishtëthi i fletës së rrapit).

dredhak, -e — Ky mbiemën përdoret ma tepër për të tregue cilësinë e një njeriu (njeri dredhacak — shih edhe Fjalorin e Institutit të Shkencave 1954). Ma mirë të për dorej në këtë rast fjala *dredhor, -e*

epidermë-a — ose *mbilëkurë-a* — Mendoj se ky term duhej të lihej si internacionalizëm mbasi kalkimi i tij nuk jep vështrimin e përpikët të sendit. Fjala *lëkurë* (poashtu si frengjishtja *peau* ose rusishtja *кожа*) nuk i përgjigjet kuptimit të sotëm të termit *derma*. Kalkimi asht ba tue u mbështetë në vështrimin që ka fjala **δερμα** në greqishtin e vjetër dhe jo në kuptimin e sotëm shkencor të

saj. E njajta gja mund të thuhet edhe për termat *hipodermë* (mbilëkurë) dhe *peridermë* (rrethlëkurë). Vetë fakti se termi *endodermë* (Nr. 246) nuk asht shqipëruar asht një dëshmi në favor të vërejtjes së masipërme.

fletushkë-a — Fjala e ka një kuptim special: gazetë pa vlerë, pa randësi; prandaj ishte mirë të krijohej një fjalë e re për të dhanë ma me saktësi kuptimin e frengjishtes *bractéole*.

Mund të thuhet *fletushë*.

gjethe të rrueshme — Ma mirë të përdoret mbiemri të *rrueshme* që asht ma eufonik dhe nuk len rast për ngatërresa me foljen *rruej*.

gjethim-i — Mund të vihet edhe folja *gjethem*, mbiemri *gjethatak*, emri *gjethnajë* që përdoren rendom në laminë e botanikës; poashtu duheshin shtue edhe dy mbiemna, *gjethembajtës*, *gjetherënës* (bimë *gjethembajtëse*, bimë *gjetherënëse*)¹⁾

insektngrënës — Ma mirë të bahej *insektengrënës*, ashtu si insektevrasës (shih nr. 247). Por këtu mund të gjindemi para një gabimi shtypi dhe jo para një inkonsekuence

jetërushqyes — Mund të lihet fjala *heterotrof* me prejardhje nga greqishtja dhe që takohet edhe në gjuhët e tjera.

kërceullh-i — Megjithëse fjala asht krijuar simbas natyrës së gjuhës shqipe, me prapashtesën *-th* bashkimi i njipasnishëm i bashkëtingëlloreve *-llth* e vështirëson kaqë shumë shqiptimin e fjalës sa zor të përhapet një formim i tillë.

kokër-a — Duhet *kok/ërr*. *-rra*; edhe këtu mund të gjendemi para një gabimi shtypi ose një "lapsus calami" mbasi në nr. 516 kemi kokërrizë.

kupë-a — Për fjalën *kupë* në tekstet e botanikës ka qënë përdorë edhe fjala *kelk-u*. Më duket kjo e fundit ma e përshtatëshme mbasi *kupë* asht tepër e përgjithëshme. Pastaj edhe fjala e prejardhur *kelkor* do t'ishte ma e përshtatëshme si mbiemër se *kupës*, e që kur shqiptohet ngatërrohet me *kupëz-a* (fr. *calicule*).

Kështu do t'i shmangeshim edhe homofonisë në mes të mbiemnit *kupës-e* dhe emnit *kupëz-a*.

majucë-a — Nuk ndëgjohej ky emër në gjininë femënore; kemi *majuc-i* (Shih Fjalorin e Institutit të Shkencave, 1954).

mëllugë ose *luspë* — Në fjalorin e Institutit kemi sinonimin *griskël* për *luspë*. *Mëllugë* na duket një fjalë tepër e rrallë për të cilën nuk ndihet nevoja përdërisa kemi dy të tjera ma të njohuna për emërtimin e të njajtit send.

i ngrënë — Për termin frengjisht *érodé* asht ma e përshtatëshme dhe ma e saktë fjala shqip *i, e brejtur*.

verdhez-a — Megjithëse ketu jemi në laminë e botanikës prapsepër fjala *verdhez* në shqip shënon një sëmundje të caktueme që u bie njerëzve prandaj nuk duhet dhanë për *klorozen* e bimëve.

Ndonji e metë aty këtu, e pashmangëshme në punime të kësaj natyre nuk ja ul vlerën fjalorit i cili me siguri do të mirëpritet nga specialistët, teknikët dhe arsimtarët e çdo kategorije, që nga ata të shkollave fillore deri tek ata të shkollave të larta. Detyra e scicillit asht të xhvishet prej çdo paragjykimi, nga çdo përrulje e kotë para fjalëve të hueja të panevojëshme dhe të fillojë ta zbatojë këtë terminologji në shkollë, në laborator, në fabrikë ose në punishte.

Për të mbyllë këto vërejtje rreth fjalorit terminologjik të botanikës nuk gjejmë fjalë ma të përshtatëshme se ato me të cilat përfundon parathania e tij. "Duke përdorur një terminologji sa më shqipe, të qartë dhe të njësuar, nocionet shkencore dhe teknike do të përvehtësohen më lehtë nga brezi i ri, shkencë dhe teknika do të përhapen dhe do të shtrihen më lehtë në gjë të masave tona punonjëse, të cilat i janë përveshur me vetmohim ndërtimit të socializmit në të gjitha fushat e ekonomisë dhe të kulturës".

Ferdinand Leka

1) Shih: I. Mitrushi — Drurët dhe shkurret e Shqipërisë, fq. 127